



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА
ENTI SHETËROR I REVIZIONIT
STATE AUDIT OFFICE

Abstrakti i raportit përfundimtar i revizionit

Subjektet kyçe të përfshira në raportin e revizionit:

Ministria e Financave – Drejtoria e Doganave e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Lënda e revizionit:

Revizioni i raporteve financiare bashkë me revizionin e pajtueshmërisë së llogarisë së buxhetit themelor 637 për vitin 2021.

Qëllimi i revizionit:

Nëse raporti financiar është i liruar nga paraqitjet e gabuara materialisht dhe nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet në to janë në pajtim me rregullativën ligjore.

Gjendjet kyçe të konstatuara:

- regjistrimi i mjeteve dhe detyrimeve nuk është zbatuar në tërësi në pajtim me rregullativën ligjore;
- nuk është kryer rivlerësimi i vlerës së tokës,
- për një pjesë të stoqeve dhe materijaleve nuk është vendosur evidenca e plotë materiale dhe financiare.

Mendimi i dhënë *:



Shprehëm mendim me rezervë për vërtetësinë dhe objektivitetin e raporteve financiare dhe mendim pa rezervë për pajtueshmërinë me rregullativën ligjore, udhëzimet dhe politikat e vendosura.

Rekomandimet kyçe:

- kryerja e regjistrimit të mjeteve dhe detyrimeve me zbatimin e plotë të rregullativës ligjore;
- sigurimi i të dhënave për vlerësimin e tokës dhe evidentimin e tij;
- vazhdimi me aktivitetet e filluara për vendosjen e evidencës materiale dhe financiare të një pjese të stoqeve.

Dobësitë kyçe të sistemit:

- përcaktimi i vendeve të punës specifike për një pjesë të nëpunësve doganor;
- pëlqim nga Qeveria për çregjistrimin e sendeve të cilët janë të papërdorur dhe përqendruar;
- miratimi i aktit nënligjor për shlyerjen e kërkesave të vjetëruara;
- riregullimi i Protokollit për bashkëpunim të ndërsjellë ndërmjet Drejtorisë së Doganave dhe Drejtorisë së të Ardhurave Publike.

Vërejtjet e marra të draft-raportit: Janë marrë vërejtje për Draft-Raportin e revizorit të autorizuar shtetëror

Përgjigje e vërejtjeve të marrë:

Vërejtjet paraqesin njoftim për masat e marra pas rekomandimeve të dhëna dhe një është pranuar për shkak të dokumentacionit shtesë të dorëzuar.

* pozitive, me rezervë të pavolitshëm të përmbajtur